

MUZEU KOMBËTARE I ARTIT MESJETAR, KORÇË

- Muzetë do të jenë të hapura për vizitorët gjatë gjithë ditës.
- Emision në Tv Korca për vlerat e muzeut tonë si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Kombëtare.
- Vizitë e organizuar në ekspozitën e muzeut nga një grup studentesh të Universitetit Fan. S. Noli, Korçë.
- Ristrukturim i sallës së ekspozitës me disa objekte të pa ekspozuara.
- Ekspozitë me koleksione pikturash të punonjesve të muzeut 16–26.05.2014.
- Ekspozitë me koleksione të hershme, me botime të vjetra librash në gjuhën shqipe (në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit), fotografi origjinale të personaliteteve e figurave të shquara të lëvizjes për çlirim kombëtar.

MUZEU KOMBËTAR ETNOGRAFIK DHE GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU, KRUIJË

- Muzetë e Krujës do të jenë hapur dhe hyrja për vizitorët do të jetë falas
- Në ambientet e muzeut do ketë broshura shqip-anglisht me informacion rreth aktivitetit, të cilat do tu shpërndahen në muze nga fëmijë të shkollave në Krujë.

MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

Bashkëpunimi i radhës i MHK me koleksionistët është ekspozita që do të hapet më 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve. Në këtë ekspozitë marrin pjesë shoqata të koleksionistëve dhe koleksionistë të veçantë, si:

- Niko Xharo, president i Koleksionistëve të Shqipërisë, që do të paraqesë në këtë ekspozitë koleksione nga fusha e filatelistë dhe monedhave etj.
- Shpëtim Sala, me një koleksion të pasur nga historiku i shkollave shqipe, me tekste, dëftesa, programe, fletore shënimesh, organe të botuara nga shkollat shqipe, mjete dhe artikuj mësimore, duke filluar nga v.1887 – 1944 etj.
- Linda Spahiu, Luljeta Dano, Edlira Sulaj, me kostume popullore e pjesë të veçanta të tyre, të krahinave të ndryshme të vendit.
- Lulëzim Perati, i cili do të prezantohet me një koleksion bizhuterish e elemente të tjera nga trashëgimia jonë kulturore.

Nata Evropiane e Muzeve 17 maj 2014

Për herë të parë MHK do të qëndrojë hapur për vizitorët deri në orët e vona të natës, më 17 maj, Natën Evropiane të Muzeve, me një program të posaçëm në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Fëmijve, si një risi e re e sjellë për herë të parë, në mjediset e MHK. Programi për këtë veprimtari në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijeve Veprimtaria do të nisë në orën 18.00

- Një historik i shkurtër MHK, shoqëruar me foto të ndryshme nga pavijonet e muzeut, të shfaqura në videoprojektor.
- Shfaqje teatrale për fëmijë.
- Këngë dhe valle popullore nga fëmijët e grupmoshave të ndryshme. Recitime dhe pjesë të ndryshme instrumentale.
- Ekspozitë pikturë.